

## Universiteti I Gjirokastrës në inagurimin e vitit të ri Akademik dhe 729 vjetorit të Universitetit të Maceratës

Universiteti Macerates – Itali I themeluar ne vitin 1290, inaguroi zyrtarisht me 11 prill vitin akademik. Në 729 vjetorin e lindjes së Universitetit të Maceratës, përshëndeten akademikë, rektor, përfaqësues te stafit teknik dhe administrativ ,student si dhe rektorë dhe perfaqesues te universiteteve të tjera, me të cilat UNIMC ka ndërtuar kurse që kulmojnë në programe të përbashkëta studimi dhe diplomimi. Në përfundim të eventit, profesorët Donatella Bisconti (Universiteti i Clermon Auvergne), Valbona Duri (Universiteti i Gjirokastrës), Henri Sardaryan (Universiteti Shtetëror i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Moskë - MGIMO), Zhou Zuoyu (Universiteti Normal i Pekinit) etj, kanë firmosur në një pergamenë, një lloj angazhimi paraprak për të ardhmen , "Karten e Maceratës", një dokument për të mbajtur gjallë marrëdhëniet midis universiteteve, kulturave dhe dialogut.





Universiteti I Maçeratës është një partner i rëndësishëm për Universitetin tonë, i cili ka qënë dhe vazhdon të jetë pjesë e prioritetëve të UNIMC (Universitetit I Maceratës). Bashkëpunimi midis dy universiteteve tona daton në vitin 2006, me nënshkrimin e Marrëveshjes Kuadër të bashkëpunimit shkencor dhe akademik. Një vit më vonë bashkëpunimi ynë konkretizohet me nënshkrimin e Marrëveshjes për Kursin Master në Arkeologji. Në vitin 2009-2010 nis Kursi i Nivelit të Dytë të Studimeve Master : “ Arkeologji dhe Administrim i Pasurisë Arkeologjike” një bashkëpunim i dy universiteteve tona.

Kemi bashkëpunuar për të mundësuar një program të ri të studimit master me titull të dyfishtë “ Arkeologji, Histori dhe Administrim i pasurive kulturore” të Universitetit të Gjirokastrës dhe “Kërkime historike dhe burimet e kujtesës” të Universitetit të Maçeratës. Kjo përbën një hap të rëndësishëm me qëllim të përmirësimit të programeve mësimore dhe nxitjes së marrëdhënieve ndërkombëtare midis dy universiteteve tona. Për Universitetin e Gjirokastrës dhe gjithë universitetet publike, ky program përbën të parin dhe të vetmin program të kësaj natyre. Një arritje e rëndësishme për UGJ dhe në veçanti për studentët shqiptarë.